



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2023:126977  
Datë: 05.04.2024  
Numri i dokumentit: 05550608

**PAKR.nr.152/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku - kryetar, Xhevdet Abazi dhe Kadrije Goga-Lubishtani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ardianë Morina, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. A. nga Gjilani, për shkak të veprave penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit B. A. av. D.M. dhe av. F.L., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Gjilan, PKR.112/23 i datës 28.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPRK-së, me datën 29.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e përbashkët e mbrojtësve të akuzuarit B. A., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.112/23 i datës 28.12.2023, vërtetohet.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Gjilan, me aktgjykimin PKR.112/23 i datës 28.12.2023, të akuzuarin B. A., e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, dhe për këto vepra penale pasi më parë i ka shqiptuar, për veprën e parë penale dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy vjet) e 4 (katër) muaj, ndërsa, për veprën e dyte penale dënimin me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimeve për veprat penale në bashkim bazuar në dispozitat e nenit 76 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €, dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjet, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 13.06.2023, e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit të ankimuar, dënim ky i cili do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa, nëse i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin me gjobë brenda afatit të paraparë ligjor, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që, një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Të dëmtuarit E. B.. dhe F.H., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike i ka udhëzuar në procedurë kontestimore.

I akuzuari është obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 100 €, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, ashtu që, nga i njëjti i janë konfiskuar lëndët narkotike të llojit kokainë në peshë prej 5 gram dhe marihuanë në peshë prej 1.5 gram, si mjete me të cilat janë kryer veprat penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

Mbrojtësit e të akuzuarit B. A., av. Driton Musliu, dhe av. Florent Latifaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të dëmtuarit E. B.. dhe F.H., të akuzuarin B. A. dhe mbrojtësit e tij, av. Driton Musliu dhe av. Florent Latifaj. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i akuzuari B. A. dhe mbrojtësi i tij, av. Florent Latifaj, ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantoi Prokuroria e Apelit e as të dëmtuarit E. B.. dhe F.H. si dhe av. Driton Musliu. Në seancën e kolegjit, mbrojtësi i të akuzuarit av. Florent Latifaj, pasi më parë bëri elaborimin e pretendimeve ankimore ngeli në tërësi pranë propozimeve si në ankesë, të cilin e përkrahu edhe i akuzuari që ishte prezent në seancën e kolegjit.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/L.nr.151/23 të datës 11.03.2024, ka propozuar që ankesa e përbashkët e mbrojtësve të akuzuarit B. A., të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPRK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Në bazë të ankesës së përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit av. Florent Latifi dhe av. Driton Musliu, por, edhe shkresave në lëndë vërtetohet se i akuzuari B. A., në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, që me aktakuzë i vihet në barrë dhe përkitazi me këtë, kryetari i trupit gjykues është pajtuar me një pohim të tillë, konformë dispozitave të nenit 241 e lidhur me nenin 242 të KPPRK-së. Përkitazi me këtë, pra, për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, mbrojtësit e të akuzuarit B. A., av. Driton Musliu dhe av. Florent Latifaj, me ankesë aktgjykimin e ankimuar e kanë kundërshtuar, përveç, vendimin për dënim edhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë, e ka shpallur fajtor të akuzuarin B. A., për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke u bazuar në pranimin e fajësisë, mirëpo, e njëjta - pra, gjykata e shkallës së parë, këtë e ka bërë në kundërshtim me dispozitat e parapara për pranim të fajësisë dhe atë duke bërë kështu shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase, në rastin konkret i akuzuari B. A., e ka pranuar fajësinë për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe atë për tri raste të caktuara që ka ndodhur në vazhdimësi, por, pavarësisht kësaj aktgjykimi në fjalë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe atë nga dispozitat e nenit 384 par. 2 nën par. 7 e lidhur me nenin 369 par. 7 të KPRK-së, ku, me dispozitat në fjalë kërkohet që gjykata në mënyrë të qartë dhe të plotë të paraqet faktet dhe rrethanat e vërtetuara apo të pa vërtetuara e duke dhënë kështu arsyeza përkitazi me këtë e në mënyrë të veçantë paraqet vlerësimin e sajë edhe për saktësinë e provave kundërtënës, për çka, konsiderojmë se në rastin konkret aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për arsye se ka aprovuar gjendjen faktike e cila nuk ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë sidomos, kur, është fjala për lëndime trupore për zyrtarët policor E. B. dhe E. Rr., ku, për të njëjtit edhe pse konstatohet se kanë pësuar lëndime trupore në shkresa të lëndës nuk ekziston asnjë ekspertizë mjeko ligjore përkitazi me lëndimet në fjalë, e që një gjë e tillë nuk vërtetohet as nga video incizimet nga vendi i ngjarjes, prandaj, rezulton se në rastin konkret nuk përmbushen elementet e veprës penale në fjalë, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor në bazë të pranimin të fajësisë. Më pastaj, përkitazi me këtë bazë ankimore, me ankesë vazhdohet edhe për veprën e dytë penale, pra, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, me arsyetim se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase, edhe përkitazi me këtë vepër penale nuk janë vërtetuar të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë elementet qenësore të veprës penale në fjalë, ashtu që, edhe përkundër faktit se i akuzuari ka pranuar se ka poseduar substancën

narkotike të llojit dhe peshës së përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar dhe atë vetëm për konsumim personal, prapë se prapë një gjë e tillë nuk është vërtetuar me prova konkrete, sidomos, kur, dihet se në vendin e ngjarjes substanca narkotike e llojit kokainë është shpërndarë në ulëse të veturës, kurse, një pjesë e vogël ka mbetur në qese, kështu, që me asnjë provë konkret, pra, ekspertizë përkatëse nuk është vërtetuar saktë sasia e substancës narkotike, për çka, konstatimi i gjykatës së shkallës së parë, si në dispozitiv por, edhe në arsyetim bie ndesh drejtë për së drejti me dispozitat e nenit 369 par. 7 të KPPRK-së, për çka, edhe propozon anulimin e aktgjykimit të ankimuar dhe kthimin e çështjen në rivendosje.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të cekura si me lartë, përkitazi me veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 322 të KPPRK-së, përkitazi me pranimin e fajësisë dhe në rastin konkret edhe nga shkresat në lëndë, rezulton se në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës për çka, përkitazi me këtë është pajtuar edhe kryetari i trupit gjykues dhe i akuzuari, pastaj, edhe mbrojtësi i tij nuk kanë paraqitur vërejtje sa i përket pranimin të fajësisë së të akuzuarit për të gjitha pikat e akuzës, për çka, edhe rrjedh se gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar drejtë dispozitat e nenit 322 e lidhur me nenin 242 të KPPRK-së, dhe ka marr aktgjykim të ligjshëm-pra, në bazë të pranimin të fajësisë. Po ashtu, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për vepër penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, por, për vepër tjetër penale dhe se përkitazi me këtë në shkresa të lëndës nuk ka ekspertizë mjeko-ligjore në bazë të cilës do të vërtetoheshin lëndime trupore, janë të pabazuara, ngase, në rastin konkret i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe me vetë faktin që është pranuar fajësia nga gjykata e shkallës së parë, ka qenë e domosdoshme të bëhet një vlerësim i tillë, pra, i pranimin të fajësisë, duke nënkuptuar edhe faktet dhe rrethanat se a ka pasur prova të mjaftueshme që mbështesin këtë pranim të fajësisë, gjë që, në rastin konkret edhe ka konstatuar se ka edhe prova që mbështesin pranimin e fajësisë, e që, të njëjtat i i janë bashkangjitur aktakuzës, e që, është fjala për vetë deklaratën e të akuzuarit, vërtetimin për konfiskim, raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, foto dokumentacionin, deklaratat e dëshmitarëve A.B., F.H. dhe G. J., dokumentacioni mjekësor për të dëmtuarit E. B.. dhe E. Rr., fakte këto dhe rrethana që i akuzuari nuk i ka kontestuar, që do të thotë se, për ekzistimin e veprës penale në fjalë është irelevante se a bëhet fjalë edhe për lëndime trupore të natyrës së lehtë apo të rëndë, ngase, sipas dispozitës së nenit 356 par. 1 të KPRK-së, nuk kërkohet që gjatë shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm medoemos, të shkaktohen edhe lëndime trupore, gjë që, kjo kërkohet për formën kualifikuese të veprës penale në fjalë, pra, sipas paragrafit 4 të nenit në fjalë, pra, kur është fjala për formën e kualifikuar të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, pra, kur, ka edhe lëndime të rënda trupore apo dëm të madh-pra, substancial, e që në rastin konkret i akuzuari nuk është akuzuar për këtë formë kualifikuese të veprës penale në fjalë, pra, për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 4 e lidhur me par. 1 dhe nenin 77 të KPRK-së, por, për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, pra, në rastin konkret mjafton vetëm shkaktimi i rrezikut të madh për jetën e njerëzve apo edhe dëm të konsiderueshëm pasuror, prandaj, në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë, edhe e ka aprovuar pranimin e fajësisë edhe pa ekspertizë mjeko-ligjore, prandaj, në këtë drejtim janë të pabaza pretendimet e mbrojtësve të akuzuarit, se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë. Prandaj, duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe për një gjë të tillë është pajtuar edhe kryetari i trupit gjykues, prandaj, konsiderohet se edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të plotë, ngase, pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, pra, edhe deklaratën e vetë të akuzuarit, i cili ka pranuar

veprimet inkriminuese të përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, e që përkitazi me këtë ka edhe prova materiale në shkresë të lëndës, e që si të vërteta i ka paraqitur faktet dhe rrethanat të përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, që do të thotë se janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në fjalë, prandaj, në këtë drejtim plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, për çka, edhe përkitazi me këtë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme, prandaj, kjo gjykatë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjendja faktike në këtë çështje penale-juridike përkitazi me veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, nuk ka qenë objekt i vlerësimit të kësaj gjykate, ngase, me ankesa nuk ka mund të kontestohet, pasi që i akuzuari, në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë konform nenit 322 par. 4 të KPRK-së, prandaj, në këtë drejtim pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit për këtë vepër penale nuk u morën parasysh.

Po ashtu, edhe pretendimet ankimore në drejtim të shkeljes së Ligjit Penal, me arsyetim se në veprimet e të akuzuarit B. A., nuk ekzistojnë tiparet e veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, duke pretenduar kështu se, gabimisht i akuzuari B. A., është shpallur fajtor për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ngase, në rastin konkret mund të flitet për vepër tjetër penale, por, kurrësi për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, kjo, gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore në fjalë nuk qëndrojnë, ngase, duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, gjë që, nuk kontestohet as nga i akuzuari, ku, edhe është vërtetuar se i njëjti-për, i akuzuari ka ndërmarrë të gjitha veprimet inkriminuese të përshkruara më detajisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padryshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në vazhdimësi nga neni 356 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur Ligji Penal në dëm të akuzuarit, sikur që pretendon mbrojtësit e të akuzuarit B. A., av. Florent Latifaj dhe av. Driton Musliu, vetëm për faktin se gjykata nuk e ka vërtetuar natyrën e lëndimeve trupore tek të dëmtuarit përmes ekspertizës mjeko-ligjore, ngase, sikur që rezulton nga shkresat e lëndës, i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale në fjalë dhe atë pa bërë asnjë vërejtje nga i akuzuari apo mbrojtësi i tij në këtë drejtim, prandaj, gjykata e shkallës së parë, ka aprovuar pranimin e fajësisë dhe e ka shpallur fajtor të akuzuarin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, prandaj, edhe në këtë drejtim nuk ka shkelje të ligjit penal, sikur, që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarit.

Po ashtu, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale as ato të paraqitura për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, me pretendim se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të

procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 1 nën par. 10 e lidhur me dispozitat e nenit 369 par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe gjithashtu edhe përpilimi i dispozitivit, është bërë konform dispozitave të nenit 369 par. 4 e lidhur me nenin 364 të KPPRK-së, ku, janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat përkitazi me ngjarjen kritike duke përfshirë këtu llojin dhe sasinë e substancës narkotike, por, edhe vendin ku është gjetur substanca narkotike në fjalë, fakte dhe rrethana këto nga të cilat plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, për të cilën i akuzuari B. A., edhe është shpallur fajtor. Në arsyetimin e aktgjyqimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsyerat e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke vepruar kështu, pra, konform dispozitave të nenit 369 par. 6 të KPPRK-së, ku ka paraqitur arsyerat për çdo pikë të aktgjyqimit dhe atë si ato faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par. 2, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 369 par.7 të KPPRK-së, pra, duke marr parasysh edhe deklaratën e të akuzuarit, kur, për substancën narkotike në fjalë e pranon se është e tij, pra, duke përfshirë këtu llojin dhe sasinë e substancës narkotike, për çka, edhe nga organet hetimore përmes testit fushor është vërtetuar sasia dhe lloji i substancës narkotike, e që vetë i akuzuari nuk e ka kontestuar, prandaj, edhe gjykata nuk ka bërë ekspertizë tjetër, mirëpo, duke pretenduar i akuzuari se substancën në fjalë e ka poseduar për konsumim personal, për çka, përkitazi me këtë, pra, faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, e ka dhënë vlerësimin e sajë, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Prandaj, përveç, që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur i dyshimtë ose i pavërtetuar dhe përveç që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, dhe po ashtu edhe për mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga i akuzuari dhe atë duke marre parasysh se pari vete deklaratën e të akuzuarit, i cili nuk i mohon faktet dhe rrethanat e përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjyqimit të ankimuar, pra, përkitazi me substancën narkotike që është gjetur dhe sekuestruar duke përfshirë vendin dhe paketimin dhe atë me arsyetim se të njëjtin e ka poseduar me qëllim të konsumimit personal, për çka, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjale, pra, se i akuzuari e kishte poseduar substancën narkotike për shitje, gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e saj e ka bazuar përveç, në deklaratën e vetë të akuzuarit, sikur që u cekë më lartë, edhe në provat materiale në shkresa të lëndës, e sidomos, vërtetimi për sekuestrim të substancës narkotike, ku, vërtetohet se të akuzuarit i është sekuestruar substanca narkotike në fjalë, që do të thotë se një sasi e tillë e substancës narkotike e paketuar në disa vende, pra, ndarjen e sajë pjesë pjesë, por, duke marr parasysh edhe llojin e substancës narkotike, pra, bëhet fjalë për lloje të ndryshme të substancës narkotike, heroinë dhe marihuanë, pastaj, mënyrën se si e ka shpërndarë në automjet në momentin kur është ndalur nga policia, pa dyshim që nuk është përdorur vetëm për konsumim personal, që do të thotë, se nuk mund të flitet vetëm për posedim të paautorizuar, sikur që pretendon i akuzuari, por, bëhet fjalë për posedimin e substancës narkotike, me qëllim të shitjes, fakte, këto dhe rrethana që janë vërtetuar edhe përmes provave materiale në shkresa të lëndës, si vërtetimi për sekuestrim të substancës narkotike në fjalë, raporti i testit fushor, ku, është përcaktuar lloji dhe sasia e substancës narkotike, foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera në lëndë, prandaj, edhe gjykata e shkallës së parë, edhe ka aprovuar

konkludimet e saja, të cilat si të drejta, të ligjshme dhe të argumentuara i aprovon edhe kjo gjykatë, sidomos, kur konstaton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit B. A., plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, që do të thotë se edhe pretendimi i mbrojtësve të akuzuarit B. A., av. Florent Latifaj dhe av. Driton Musliu, se nuk janë vërtetuar elementet objektive dhe subjektive të veprës penale në fjalë, janë të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe shkresa tjera të lëndës.

Prandaj, në bazë të cekurave si më lartë, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 10 e lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, sikur që pretendohet në ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal si dhe gjetjet e kësaj gjykate, përkitazi me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, përkitazi me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, me ankesë në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, sidomos, kur, merret parasysh se e gjithë gjendja faktike është vërtetuar në bazë të një testi fushor e jo në ekspertizë përkatëse, pastaj, se përkundër posedimit të substancës narkotike në fjalë, të njëjtën i akuzuari nuk e ka poseduar me qëllim shitje, por, për konsumim personal, që do të thotë se vetëm fakti se i akuzuari ka poseduar substancën narkotike në fjalë, nuk do të thotë apriori se qëllimi ka qenë për shitjen e së njëjtës, e pa e marr fare parasysh pretendimin e të akuzuarit se të njëjtën e ka poseduar për konsumim personal, për çka, gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit B. A., kur, të njëjtin e ka shpallur fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, në këtë çështje penalo-juridike gjykata e shkalles se pare, në mënyrë të pakontestueshëm ka vërtetuar se ditën kritike pas kontrollit dhe bastisjes së automjetit të akuzuarit B. A., të njëjtit - pra, të akuzuarit, i është gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike e llojit dhe sasisë të përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, fakte këto dhe rrethana të cilat përveç, që nuk kontestohen nga i akuzuari kanë mbështetje edhe në provat materiale në shkresa të lëndës, si raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, vërtetimi për sekuestrimin e substancës narkotike, raporti i testit fushor për llojin dhe sasinë e substancës narkotike, foto dokumentacionin dhe shkresat tjera në lëndë.

Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese se substanca narkotike në fjalë a ishte në posedim të akuzuarit me qëllim të shitjes apo vetëm për konsumim personal, sikur që pretendon i akuzuari por edhe mbrojtësit e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, ka marr parasysh, përveç, mbrojtjes së të akuzuarit, i cili nuk i konteston faktet dhe rrethanat se si është gjetur substanca narkotike në automjetin e tij, pastaj, llojin e as peshën, por, as mënyrën se si është gjetur substanca, pra, e ndarë në disa pjesë, por edhe faktin se substanca në fjalë ka qenë e llojeve të ndryshme, atëherë, pa dyshim që nuk mund të flitet për posedim të substancës narkotike në fjalë, vetëm për

konsumim personal, prandaj, janë të gjitha këto fakte dhe rrethana që vërtetojnë se i akuzuari substancën narkotike në fjalë, e ka poseduar me qëllim të shitjes, që do të thotë se në veprimet inkriminuese të akuzuarit plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, e jo të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, sikur që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarit.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura, si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari B. A., është kryerësi i veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshim është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit B. A., nuk janë të bazuara.

Në ankesën e mbrojtësve të akuzuarit B. A., av. Florent Latifaj dhe av. Driton Musliu, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet se aktgjykimi i ankimuar është i kundërligjshëm për arsye se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka shpallur fajtor të akuzuarin për veprat penale të cilat nuk i ka kryer, por, gjithashtu, edhe vendimi për dënim nuk është i drejtë, mirëpo, edhe përkundër kësaj prapë se prapë vetë lartësia e dënimit është shumë e lartë, sidomos, kur, merret parasysh sasia e substancës narkotike, pastaj, se gjykata e shkallës së parë, nuk i ka zbatuar dispozitat e parapara për zbutje të dënimit, ngase, në rastin konkret është dashur të merret si rrethanë lehtësuese bashkëpunimi i të akuzuarit me gjykatën, pranimi i fajit si dhe keqardhja e shprehur nga i akuzuari, prandaj, edhe propozon që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh rrethanat e vërtetuara e në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit për veprat e kryera penale e në të cilat thirren në arsyetimin e aktgjykimit, e duke i vlerësuar të njëjtat - pra, rrethanat në fjalë përkitazi me pretendimet ankimore, kjo gjykatë i gjen si të pa bazuara pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit, se ka vend për shqiptimin e dënimit më të butë, se sa dënimin që i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Në rastin konkret, në këtë çështje penale-juridike, gjykata e shkallës së parë, bazuar në dispozitat e nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, para se të shqiptojë dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, të akuzuarit i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat e parapara sipas dispozitave për shqiptimin e dënimit, kështu që, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin i ka marrë pranimin e fajësisë, se është penduar për kryerjen e veprës penale, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepër tjetër penale, sjelljen korrekte në gjykatë, ndërsa, rrethana rënduese ka marrë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, pastaj, vendosmërinë për kryerjen e veprës penale, numrin e të dëmtuarve dhe në praninë e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të konstatuara si më lartë, gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse ka vlerësuar të gjitha rrethanat ashtu sikur që parashihen me dispozitat e nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjë që, mënyrën e vlerësimit të rrethanave nga gjykata e shkallës së parë, e aprovon edhe kjo gjykatë, e sidomos, kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ngase, në rastin konkret, pikërisht, si rezultat i pranimi të fajësisë por, edhe rrethanat tjera lehtësuese të akuzuarit dhe i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar dhe atë duke bërë kështu, një baras peshim të rrethanave rënduese me ato lehtësuese, ku, ka marr parasysh edhe faktin se tek vepra penale në vazhdim, bëhet fjalë për tri raste, pastaj, se kur është fjala për substancën narkotike, përveç, sasisë së konstatuar në dispozitiv, një pjesë të mirë të sasisë së substancës narkotike i akuzuari e ka shpërndarë (hedhur) në automjet në momentin e arrestimit, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve, ngase, në bazë të rrethanave lehtësuese të konstatuara dhe të vlerësuara edhe i ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, që do të thotë se dënimet në fjalë janë baras peshuar me rrethanat lehtësuese dhe rënduese, prandaj, edhe ankesa e mbrojtësve u refuzua si e pabazuar, për çka, edhe konsiderojmë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, duke marr parasysh edhe faktin se bëhet fjalë për tri raste të veprës penale në vazhdim, është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase, është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikshmërisë së veprave penale, e po ashtu, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u parashtrua më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.152/2024, të dt. 29.03.2024**

Procesmbajtëse,  
Ardianë Morina

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,  
Hashim Çollaku

1.Xhevdet Abazi

2.Kadrije Goga-Lubishtani

Numri i lëndës: 2023:126977  
Datë: 05.04.2024  
Numri i dokumentit: 05550608